



UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË

Kryesues i KD-së

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja

Nr. Prot. 2383 Dt 06.12.2021

Këshilli Drejtues i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, bazuar në kompetencat e përcaktuara me nenin 24 dhe 56 të Statutit të Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 03.12.2021, mori:

**VENDIM**

***Mbi caktimin e prioriteteve për ekzekutimin e Kontratës Kolektive***

- I. Personelit akademik dhe administrativ të pensionuar në UIBM, në vitin 2017 dhe 2018, në përputhje me nenin 35, paragrafi 8 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, nr. 013, 2056, të datës 18.04.2017, u lejohet kompensimi në emër të shpërblimit jubilar dhe kompensimi në lartësi të tri (3) pagave përcjellëse sipas mesatares së tri pagave të fundit.
- II. Ekzekutimi i pagesës për pensionistët që janë në sistem do të bëhet me pagën e muajit dhjetor të vitit 2021, ndërsa ekzekutimi i pagesës për pensionistët që nuk janë në sistem të pagave do të bëhet nga regjistri pas aprovimit nga Thesari.
- III. Personelit të administratës që ka pranuar një pagë përcjellëse pas pensionimit, pas hyrjes në fuqi të Kontratës me nr. prot. 2056, datë 18.4.2017, duhet t'i përlllogaritet paga përcjellëse pas pensionimit mbështetur në parag. 9 të nenit 35, duke zbritur diferencën/shumën e mjeteve të pranuar sipas akteve tjera.
- IV. Personelit të administratës së UIBM, në përputhje me nenin 35, paragrafi 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, nr. 013, 2056, të datës 18.04.2017, u lejohet kompensimi për ushqim (shujta) gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, si dhe kompensimi në emër të shpërblimit jubilar, sipas përqindjes mbi pagën bazë.
- V. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy (2) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në UIBM, ndërsa vlera e kompensimit të pagës jubilarë bëhet në pagën bazë.
- VI. Kompensimi i ushqimit në punë (shujtës) nuk jepet për të periudhat e pushimit vjetor, pushimit të lehonisë, pushimit mjekësor, ditët e udhëtimit zyrtar dhe mungesat në punë për çfarëdo arsye.
- VII. Ekzekutimi i pagesave nga pika V do të bëhet me pagën e muajit dhjetor të vitit 2021, për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 31.12.2020, respektivisht nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive.
- VIII. Personelit të administratës që ka pranuar shpërblimin jubilar pas hyrjes në fuqi të Kontratës me nr. prot. 2056, datë 18.4.2017, duhet t'i përlllogaritet shpërblimi jubilar mbështetur në parag. 8 të nenit 35, duke zbritur diferencën/shumën e mjeteve të pranuar sipas akteve tjera.
- IX. Kompensimi për kategoritë e tjera të personelit, do të bëhet me një vendim tjetër të Këshillit Drejtues.
- X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues i UIBM, duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, nr. 013, 2056, të datës 18.04.2017, e lidhur në mes MASHT-it dhe SBASHK-ut, ku janë paraparë obligimet e punëdhënësit ndaj të drejtave të të punësuarve, të cilat sipas nenit 2 janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit në Kosovë, si dhe bazuar në kërkesat për kompensimin e shpërblimit jubilar, pagave përcjellëse pas pensionimit dhe shujtave nga të punësuarit e UIBM, në kuadër të buxhetit për paga dhe mëditje të miratuar sipas Ligjit të buxhetit, ka planifikuar ekzekutimin e kompensimeve të parapara sipas Kontratës Kolektive, duke përcaktuar prioritetet varësisht nga mundësitë buxhetore.

Personeli i punësuar në UIBM, me rastin e pensionimit sipas nenit 35, pikës 8 dhe 9, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, nr. 013, 2056, të datës 18.04.2017, përfitojnë kompensimin në emër të shpërblimit jubilar dhe kompensimi në lartësi të tri (3) pagave përcjellëse sipas mesatares së tri pagave të fundit.

Sipas nenit 35, pikës 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, nr. 013, 2056, të datës 18.04.2017, të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim (shujta) gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, për një ditë pune, është dy (2) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare.

Në këtë këndvështrim, Këshilli Drejtues ka planifikuar që me pagën e muajit dhjetor të vitit 2021, fillimisht të kompensojë personelin e pensionuar në vitet 2017 dhe 2018, të cilët janë në listën e pagave, ndërsa kompensimi për personelin e pensionuar në vitet 2018 dhe 2019 që nuk janë në listë të pagave do të bëhet nga regjistri pas aprovimit nga Thesari, ndërsa për kategoritë e tjera të personelit, do të vendosë me një vendim të veçantë.

Bazuar në këto që u cekën si më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Këshillit Drejtues të UIBM;
3. Menaxhmentit të UIBM;
4. Dekanëve të njësive akademike;
5. Sekretarëve të njësive akademike;
6. Zyrës për buxhet dhe financa;
7. Zyrës së personelit.



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**Kryesues i KD-së**

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja

Nr. Prot. 2382 Dt 06.12.2021

Këshilli Drejtues i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, pas shqyrtimit të kërkesës nr. prot. 1955, dt. 27.10.2021 të Sindikatës së Universitetit, si dhe bazuar në vendimin e qeverisë nr. 05/24, të dt. 12.01.2018, në mbledhjen e mbajtur më 03.12.2021, morri:

**VENDIM**

1. Për kompensimin retroaktiv të punonjësve të administratës, në emër të shtesës mujore për nëpunësit civil prej 30 euro për vitin 2018, sipas vendimit të qeverisë nr. 05/24, të dt. 12.01.2018.
2. Të gjithë punonjësit e administratës të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", kompensohen me shumën e njëhershme prej 360 euro.
3. Kompensimi i kësaj shume do të ekzekutohet me pagën e dhjetorit 2021.
4. Kompensimi do të bëhet nga buxheti i planifikuar me PCF paga dhe mëditje.
5. Obligohet Zyra për buxhet dhe financa për realizimin e këtij vendimi.

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", pas shqyrtimit të kërkesës nr. prot. 1955, dt. 27.10.2021 të Sindikatës së Universitetit kompensimin retroaktiv të punonjësve të administratës, në emër të shtesës mujore për nëpunësit civil prej 30 euro për vitin 2018, sipas vendimit të qeverisë nr. 05/24, të dt. 12.01.2018, e konsideroi të arsyeshme kërkesën, pasi një e drejtë e tillë u takon në bazë të vendimit të qeverisë. Gjithashtu, duke pasur parasysh se ka mundësi buxhetore për realizimin e kësaj kërkesë, Këshilli Drejtues mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- Arkivit të UIBM;
- Sindikatës së UIBM;
- Zyrës për buxhet dhe financa;
- Zyrës së personelit;



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**Kryesues i KD-së**

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja

Nr. Prot. 2497 Dt 10.12.2021

Në mbështetje të nenit 18 , Këshilli Drejtues i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 3.12.2021, mori:

**VENDIM**

- I. Për lejimin e mjeteve për furnizim me telefona mobil për anëtarët e Këshillit Drejtues të UIBM.
- II. Obligohet shërbimi financiar për ekzekutimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM,
2. Menaxhmentit të UIBM,
3. Shërbimit financiar



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja